

VENDIM
Nr. 54, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS
SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4 të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.

- Shoqëria “Hec Lanabregas” është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 134, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe me vendimin nr. 135, datë 6.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, modelin shqiptar të tregut të energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 153, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Lanabregas” për periudhën e tretë rregullatore”.

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me nr. 1220, prot., datë 20.3.2012 të shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani